



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 415 / Prot.
3

Tiranë, më 8/5 2013

Lënda: Rekomandim për Gazeta "Telegraf", Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 05, datë 08/05/2013

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Gazeta "Telegraf", Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 25/04/2013, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është përfunduar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, Gazeta "Telegraf", Tiranë, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

-Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të detyrave dhe përmbushjes së tyre, si dhe verifikimi i përputhshmërisë së tij me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, e konkretisht, neni 3, paragrafi 24, dhe neni 6/1, germa "a", në lidhje me:

- Pëlqimin e shprehur të subjekteve të të dhënave.

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast, si dhe provat e administruara vëren se:

1-Kontrolluesi, Gazeta "Telegraf", Tiranë, nuk aplikon mekanizmin e "Pëlqimit", i cili është një kusht i domosdoshëm në përpunimin e të dhënave personale. Kjo bie ndesh me, nenin 3, paragrafi 24, dhe neni 6/1, germa "a", të ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Ky mekanizëm, pavarësisht veshtirësisë së aplikimit të tij, sidomos në median e shkruar, të paktën të aplikohet, në rastin e mbledhjes të të dhënave, kur kemi të bëjmë me të dhëna të pacientëve, të miturve, të dhunuarve, dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve të drejtësisë, si dhe, në rastin e publikimit të fotove, por gjithashtu, duke mos harruar, të gjitha rastet e tjera të parashikuara në nenin 7, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe me Udhezimin nr.9, datë 15/09/2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në median e shkruar vizive dhe audiovizive”, dhe konkretisht Kreu VIII, “Pëlqimi”, i cili shprehet:

“1-Në përgjithësi, të dhëna sensitive, d.m.th., “të dhënat personale që mund të shfaqin mendimet racore ose etnike, fetare, filozofike ose bindje të tjera, politike, anëtarësimin në parti, sindikatat, shoqatat apo organizata fetare, si dhe të dhënat e gjendjes shëndetësore dhe jetës seksuale”, mund të përpunohen nga gazetarët vetëm kur kanë marrë pëlqimin nga subjektet, i cili mund te revokohet në çdo çast.

2- Kontrolluesi, Gazeta “Telegraf”, Tiranë, nuk ka të hartuar një rregullore të shkruar për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27/2 “c” të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” : *“udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë ne përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave”.*

Parimi i punës së kontrolluesit Gazeta “Telegraf”, Tiranë, mbështetet në Ligjin nr.8239, datë 03.09.1997, ligj i cili ka në formulimin e tij vetëm dy nene, të cilat legjitimojnë lirinë e tij.

Pavarësisht këtij fakti se, liria e shtypit konsiderohet si thelbësore në një shoqëri të lirë dhe demokratike, se liria e informacionit bazohet në lirinë e manifestimit të mendimit, në lirinë e komunikimit, kjo s’do të thotë të konsiderohet e të trajtohet si një interes mbizotërues i gazetarit.

Transparenca nuk mund të shuajë (fshijë) nevojën për intimitet dhe mbi të gjitha të drejtën e ndërtimit lirisht të sferës private të gjithsecilit për zhvillimin lirisht të personalitetit si dhe të respektimit të dinjitetit. Karta Evropiane e të drejtave të njeriut hapet pikërisht me vlerësimin më solemn “Dinjiteti njerëzor është i padhunueshëm, ai duhet të jetë i respektuar dhe i mbrojtur”.

Në këtë kuptim, kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike, do të ndeshet në radhë të parë me të drejtën e individit, subjekt i këtyre të dhënave personale, për t’i mbrojtur ato.

Ruajtja e konfidencialitetit (fshehtësi, afërsi, familjaritet, besim) si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij, nuk duhet të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër të parashikuar sipas këtij neni. Është e vërtetë se liria e shprehjes nuk i nënshtrohet censurës paraprake, por kjo censurë nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale. Duhet pasur parasysh që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat që rregullojnë lirinë e të shprehurit.

Në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , i ndryshuar **Neni 2 Parim i përgjithshëm** “ Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private”.

Neni 9, (Përpunimi i të dhënave personale dhe liria e shprehjes), i Direktivës 95/46 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 24 tetor 1995, “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si edhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”, shprehet:

“Shtetet Anëtare parashikojnë përjashtime ose derogime ndaj dispozitave të këtij Kapitulli, Kapitullit IV dhe Kapitullit VI, për përpunimin e të dhënave personale që kryhet krejtësisht për qëllime gazetarie ose për qëllime të lirisë së shprehjes letrare dhe artistike, vetëm atëherë kur këto përpunime janë të nevojshme për të përputhur të drejtën për jetën private me dispozitat që rregullojnë lirinë e shprehjes.”

Nëse do të duhet të arrihet “përputhshmëria e së drejtës për jetën private, me të drejtën e shtypit për të qënë i lirë”, atëherë ky harmonizim të drejtash, realizohet ligjërisht, dhe duke respektuar dinjitetin e palëve, nëpërmjet mekanizmit të “Pëlqimit”.

Në këto kushte, është detyrim ligjor përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe aktet e tij nënligjore.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1-Kontrolluesi, Gazeta “Telegraf”, Tiranë, në zbatim të nenit 27/2 “c” dhe nenit 28 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të përfshihet si masë emergjente për sigurinë e të dhënave personale të subjekteve, objekt të lajmit, konfidencialiteti, si dhe “Pëlqimi i shprehur” i këtyre subjekteve.

Për hartimin e këtij akti, Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj.

3-Kontrolluesi, Gazeta “Telegraf”, Tiranë, në zbatim të neneve, neni 3, paragrafi 24, 6, paragrafi 1, gërma “a”, dhe nenit 7, paragrafi 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe në përputhje me Udhezimin nr.9, datë 15/09/2010, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në median e shkruar vizive dhe audiovizive” , paragrafi 1 dhe 2 të tij, të konkretizojë në praktikat e veta të punës, dhe mekanizmin e “Pëlqimit”.

4- Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm që ju ngarkon ligji, të kryhet brenda një afati kohor prej 45 ditësh. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

5- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale : *”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

